

VENDIM
Nr.319, datë 21.4.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1301, DATË 29.12.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
LINJËS 400 KV, TIRANË-PODGORICË, NË QARKUN E SHKODRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1301, datë 29.12.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme prej 9 617 (nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 84 444 549 (tetëdhjetë e katër milionë e katërqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekësh.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Fondi, prej 84 444 549 (tetëdhjetë e katër milionë e katërqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekësh, të përballohet nga fondet e OST sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha